



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE  
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA  
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

20.02.2008

Për të gjitha Kompanitë Regjionale të Ujit

Attn: Të gjithë Drejtorëve të Kompanive

Të nderuar,

### Cilësia e Ujit të Pijes

Në një takim që kemi pasur dje me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHP), jemi njoftuar se uji i pijes që distribuohet në sistem nga disa prej kompanive të licencuara nuk dezinfektohet (me klor) dhe rrjedhimisht nuk i përmbush standardet e përcaktuara nga IKSHP.

Pas këtij informacioni ZRRUM do të shqyrtojë më detajisht këtë çështje në kuptim të sigurimit të informacionit të plotë dhe të ndërmarrjes së veprimeve përkatëse në pajtim me mandatin e vet ligjor.

Në ndërkohë, duke pasur parasysh se:

- furnizimi me ujë të cilësisë së duhur të përcaktuar me standardet në fuqi është obligim primar i kompanive publike regjionale të licencuara për ofrimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit,
- cilësia e ujit të pijes ka rëndësi fundamentale për jetën dhe shëndetin e popullatës,
- ZRRUM si autoritet rregullator ka përgjegjësi të sigurojë se uji i furnizuar nga kompanitë e licencuara duhet të jetë në pajtim me standardet e përcaktuara nga IKSHP

Kërkojmë nga ju që **urgjentisht të na njoftoni/konfirmoni nëse kompania e juaj bënë trajtimin e nevojshëm të ujit të pijes** duke përfshi edhe dezinfektimin sipas dispozitave ligjore në fuqi (Udhëzimi Administrativ 1999/2).

Me respekt,

Afrim Lajçi  
Drejtor i ZRRUM-it